



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERJON B. BARDHI
ADRESA Rruga "Kongresi i Përmetit",
God.85, Hyrja.8, Ap.62, Tiranë.
TEL: 693064265

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

Nr. repertori: 37

Nr. koleksioni: 17

Tirane më 12/01/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligi nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligi nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 119, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"

*Akti material përbëhet nga 18 fletë



A2021052740002868828

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot përpara meje Noter Erjon B.Bardhi anëtar i Dhomës së Noterëve Tirane i regjistruar pranë Organeve Tatimore QKB me numer Nipti L62227014R në zyrën noteriale të ndodhur në "Rr.Kongresi i Permetit" Zogu i Zi,perballe Ring Center,Tirane u paraqiten personalisht palet e mëposhtme te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje:

SHITES: Denis Koçi, atësia Kalem, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Babe Rexha; Nd. Private; H. 54; Njesia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 02/05/1998, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033106394 dhe nr. personal J80502051Q, (këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si *Shitës*)

BLERES: Denard Buci, atësia Fatmir, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga Babe Rexha; Njesia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 19/11/2001, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033725599 dhe nr. personal K11119048T, (këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si *Blerës*)

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQENËSE:

- A. Shitësi z. Denis Koçi është ortak dhe zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë të së drejtës shqiptare "PRIT PAK" Shpk një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, NUIS L81413016P me seli ne Rruga "Frederik Shiroka", Pallati Alba, apartamenti nr 6, Tirane, Shqipëri (në vijim referuar edhe si "Shoqëria").
- B. Blerësi z. Denard Buci, dëshiron të blejë nga Shitësi 1 (nje) Kuotë e barabartë me 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme.
- C. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit 1 (nje) kuote e barabartë me 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, (në vijim referuar edhe si "Kuota"), sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vijim;
- D. Palët deklarojnë dhe pranojnë shprehimisht se përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, të gjithë ortakët e Shoqërisë janë njoftuar për shitjen e Kuotës sipas dispozitave të statutit.
- E. Më datë 11.01.2021 përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, asambleja e përgjithshme e Shoqërisë, ka miratuar transferimin e Kuotës sipas vendimit bashkëngjitur kesaj kontrate.

Në bazë të udhëzimit nr. 2007/1, datë 02.03.2010, të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është kërkuar informacion nga noteri sipas njoftimit D pranë Regjistrimit të Barrëve Siguruese dhe nga përgjigja e dhënë nga RBS, rezulton se mbi kuotat të zotëruar nga ortakët z. Denis Kalem Koçi ne shoqerine "PRIT PAK" shpk nuk rezulton asnjë barrë siguruese.

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, Palët, pranojnë të lidhin dhe në fakt lidhin këtë Kontratë sipas kushteve të mëposhtme:

NENI 1

Denard Buci



KUSHTET PARAPRAKE

Kushtet paraprake janë pjesë përbërëse dhe thelbësore të kësaj Kontrate.

NENI 2

SHITJA E KUOTES

- 2.1. Njëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi bën dakort të shese, transferojë dhe dorzojë 1 (një) kuote e barabartë me 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar që ai zotëron në shoqërinë "PRIT PAK" Shpk, të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablejçe apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të Blerësit, i cili, pranon dhe blen, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë.
- 2.2. Shitja dhe transferimi i titullit të kuotes bëhet me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe dorëzimin e kuotes tek blerësi, i cili merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shitësit dhe në veçanti të drejtën për të marrë pjesë në fitimet e shoqërisë, për të ndalë pasurime e shoqërisë si dhe merr përsipër detyrimet dhe pasivet e mundshme. Palet bëhen dakort se pagesa e çmimit do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 3 të kësaj kontrate.
- 2.3. Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, struktura e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë "PRIT PAK" Shpk do të jetë: z. Denard Buci zotërues i 1 (një) kuote në pjesëmarrje në përqindje 100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "PRIT PAK" Shpk.

NENI 3

ÇMIMI

Çmimi i shitjes i pasurisë objekt i kësaj kontrate shitje do të jetë sa vlera e kapitalit themeltar të kuotes dhe konkretisht në vlerën 100 000 (njëqind mijë) leke të cilat janë paguar nga pala blerëse në favor të pales shitëse para nënshkrimit të kësaj kontrate sipas mandatit bashkëngjitur kësaj kontrate

NENI 4

DEKLARIME DHE GARANCI

- 4.1 Shitësi garanton Blerësin se është personi i vetëm legjitim për të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate.
- 4.2 Shitësi garanton Blerësin se Kuota objekt i kësaj Kontrate, është e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablejçe apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve.
- 4.3 Blerësi deklaron se blen Kuotën e Shitësit, sipas gjendjes së faktit dhe të së drejtës në të cilën ajo ndodhet në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 4.4 Shitësi me nënshkrimin e kësaj kontrate nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë pretendim në lidhje me 1 (një) kuote e barazvlefshme me 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "PRIT PAK" Shpk që ai zotëronte, dhe pronar i vetëm dhe legjitim pa asnjë barrë dhe detyrim ndaj të tretëve bëhet blerësi z. Denard Buci.
- 4.5 Kjo kontrate do të jetë e detyrueshme dhe do të ketë pasoja juridike ndaj paleve, trashëgimtareve të tyre, si dhe ndaj atyre të cilëve iu është cëduar në mënyrë të rregullt.
- 4.6 Me nënshkrimin e kësaj kontrate blerësi z. Denard Buci, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që shitësi ka mbi 1 (një) kuote e barazvlefshme me 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "PRIT PAK" Shpk.

NENI 5


SHPENZIMET DHE TAKSAT

- 5.1 Shpenzimet ligjore dhe taksat, shpenzimet noteriale, tarifat e regjistrimit në zyrat kompetente si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me këtë Kontratë, do të jenë në ngarkim të Blerësit.
- 5.2 Shpenzimet e tjera do të paguhën nga palet sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 6

INTERPRETIMI I KONTRATES

Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saja interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt. Nëse pjesë të kësaj kontrate janë ose bëhen të pavlefshme ose jodetyruese, palet do të jenë të detyruara të



Denard Buci

zbatojne pjesen tjetër të kontrates, Në këtë rast, palët do të zvendesojnë pjesen e pavlefshme ose jo detyruese me parashikime të vlefshme e detyruese efektet e të cilave sipas përmbajtjes dhe qëllimeve të kësaj kontrate duhet të jenë në kufijte e të mundshmes, e ngjashme me pjesen e pavlefshme ose jodetyruese.

NENI 7

MOSMARRËVESHJET

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të shfaqen, direkt ose indirekt, midis palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhjen apo vlefshmërinë e kësaj kontrate palët paraprakisht duhet të diskutojnë në lidhje me këto mosmarrëveshje për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet një marrëveshje sipas parashikimeve të bëra në këtë nen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 8

LIGJI I ZBATUESHEM

Kjo Kontrate rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe shpreh vullnetin e Palëve.

NENI 9

PERMBAJTJA E KONTRATES DHE NDERYSHIMET

Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve në lidhje me transferimin e 1 (një) kuote e barazvlefshme me 100 % (njëqind për qind) të kapitalit themeltar që zoteron shitësi, tek Blerësi dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet apo deklarimet e mëparshme në lidhje me objektin në fjalë. Ndryshime apo shfaqime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontrate vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga Palët.

NENI 10

ANEKSET E KONTRATES

Kësaj kontrate i bashkëngjiten si pjesë perberëse dhe të pandara këto dokumenta që do të quhen Anekse të kontrates. Pjesë përbërëse të kësaj kontrate është dhe dokumentacioni bashkëngjitur:

- Ekstrakti i Regjistrimit Tregëtar
- Kopje të letërnjoftimeve të personave nënshkruar
- Vendimi i Asamblese së Përgjithshme.
- Përgjigje e Regjistrimit e barres Siguruese

Unë noter Erjon B. Bardhi, hartova këtë kontratë, në 4(kater) kopje në gjuhën shqipe, që pasi u lexua nga ana ime dhe palët pjesëmarrëse, të cilat deklaruan para meje së është konform vullnetit të tyre të lirë dhe të pavesuar, në shenjë pranimi e nënshkruan në praninë time. Duke qenë i bindur për identitetin e palëve dhe vullnetin e tyre të lirë unë Noter Erjon B. Bardhi e legalizoj aktin e mësipërm në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin me nr 110/2018 date 20.12.2018 "Për Noterinë" në 4(kater) kopje me vlerë të njëjtë, nga të cilat, një kopje dorëzohet pranë QKB se, një kopje i jepet palës blerëse, një kopje palës shitëse dhe një kopje administrohet nga ana ime, pranë kësaj zyre Noterie.

PALET KONTRAKTUESE

SHITES

z. Denis Koçi

Denis Koçi

[Signature]


BLERES

z. Denard Buci

Denard Buci

[Signature]

NOTER
ERJON B. BARDHI



REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-2021011284745916
Data e Rezultatit te Kerkimit: 12.01.2021
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 8:47:46AM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-613-4592
Referenca e Pardoresit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

DENIS KALEM KOCI
PRIT PAK SH.P.K.



ACK *Q...*



Ndërmarrja: _____

"PRIT PAK"
SHPK

MANDAT PAGESE

Datë: 12/01/2020 Nr: _____

Shuma Lekë: 100.000

U Pagua: _____

Shuma lekë (me fjalë): ^{100.000} Njëqind mijë leke

Për: Pagose për shërbime të kryera të kompanisë "PRIT PAK SHPK"

me 100% të kuptimit të shërbimeve "PRIT PAK SHPK"

Financieri:

Arkëtar:

Denard Buci

Marrësi:

[Signature]